



Prof. Dr. Isak Shema

FAIK KONICA - PERSONALITET I SHQUAR I LETËRSISË DHE I KULTURËS SHQIPTARE DHE EVROPIANE

Shkrimtari Faik Konica është personalitet i shquar i letërsisë dhe i kulturës shqiptare dhe evropiane Ai është figura qendrore e epokës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare, e kulturës, e letërsisë dhe e publicistikës së gjysmës së parë të shekullit XX. Jetëshkrimi shumë interesant, botimet, studimet dhe bibliografia aq e pasur e Konicës, me kalimin e kohës, plotësohen me të dhëna dhe me kontribute të reja shkencore. Për njeriun dhe krijuesin e njohur mirë edhe nga personalitetet më të shquara të artit letrar dhe të kulturës evropiane të shekullit XX, pas kalimit të kohës së përjashtimit të Faik Konicës nga historia e letërsisë shqipe, veçanërisht pas rikthimit të tij në veprimtaritë kulturore dhe shkencore, janë shtuar botimet dhe studimet, në të cilat

ndriçohen aspekte të ndryshme të jetës dhe të krijimtarisë së tij. Është me interes të posaçëm të botohet edhe një vepër gjithëpërfshirëse studimore komparative, e cila do të zgjonte edhe më tepër kërshërinë e lexuesve dhe të studiuesve të shumtë shqiptarë dhe të mbarë botës.




Faik Konica lindi në Konicë. Në Autobiografinë e këtij shkrimtari, pastaj në tekstin “Kronikë e shkurtër e jetës dhe e veprës së Faik Konicës”, të shkruar nga Nasho Jorgaçi, si datë e lindjes shënohet prilli i vitit 1875, ndërsa në monografinë e Jup Kastartit shënohet 15 marsi i vitit 1876. Në shkrimet biografike kushtuar Konicës gjerësisht janë paraqitur shtigjet e jetës, të shkollimit, të krijimtarisë letrare dhe të veprimtarisë së gjithanshme shumëvjeçare. Që nga viti 1881-1884 në vendlindje Konica kryen shkollimin fillor, në Kolegjin Saverian të Shkodrës vazhdon mësimet e mesme 1884-1885, gjatë viteve 1885-1886 është nxënës i shkollës greke të Konicës, në Liceun Perandorak të Gallata Sarait në Stamboll qëndron gjatë viteve 1886-1887. Studimet universitare i vazhdon në Francë në College de Lisieux (Normandi) dhe në Carcassonne (1888-1893) në degën klasike për letërsi dhe filozofi, gjatë vitit 1894 studion gjuhën dhe letërsinë në Universitetin e Montpellierit, më 1895 në Universitetin e Dizhonit (Dijon) fiton diplomën për studime të letërsisë dhe të filozofisë “Bachalin est lettres-philosophie” dhe Fletë nderi nga Ministria e Arsimit. Më 1896 studion në Paris në College de France, studion gjuhët sanskrite e hindishte. Po ashtu, me albanologun francez, L. Benloew studion hebraishten. Më 1912 në Universitetin e Harvardit studion artet dhe fiton diplomën “Master of Arts”.

Faik Konica zhvillon veprimtari të gjerë kulturore, letrare, publicistike dhe shkencore. Ai shquhet edhe me veprimtarinë e dendur diplomatike. Në fushën e publicistikës që nga viti 1896

angazhohet me tërë qenien e vet për botimin e organeve të ndryshme publicistike. Kontributi i tij si poet, prozator, kritik letrar, pamfletist dhe si përkthyes është shumë i madh. Njëzet poezitë dhe prozat e tij poetike, sajojnë një vëllim poetik, në të cilin trajton motive dhe tema të larmishme. Portretet letrare dhe prozat e shkurtra, të shpërndara në shtypin dhe në periodikun e kohës, si edhe poezia, bëjnë një vepër të veçantë letrare. Në kuadër të krijimtarisë së këtij krijuesi të famshëm shquhet sidomos proza e gjatë dhe eseistike, ku bëjnë pjesë: “Katër përralla nga Zullulandi”, “Shqipëria si m`u duk”, “Doktor Gjëlpera zbulon rrënjët e dramës së Mumurrasit”, “Shqipëria-kopshti shkëmbor i Evropës Juglindore dhe shkrime të tjera”, “Çmimi i Revistës “The Jugde” etj.

Në shkrimet për gjuhën dhe për letërsinë shtron për diskutim çështje të rëndësishme të shkencave gjuhësore dhe letrare. Në qendër të vëmendjes së këtij dijetari, i cili me të drejtë është quajtur “princi i gjuhës dhe i letërsisë shqiptare”, është zhvillimi dhe standardizimi i gjuhës shqipe, historia e alfabetit të shqipes, themelimi i gjuhës letrare (të veçojmë punimet “Abetari shqip”, “Për gjuhën”, “Dialektet e Shqipërisë dhe nevoja e shkrirjes së tyre”, “Përparimi i shqipes”, “Për themelimin e një gjuhe letrare”, “Ese për gjuhët natyrore dhe artificiale” (botuar në Bruksel, më 1904 në gjuhën frënge (147 faqe), ksomblën e kësaj vepre e zbuloi Luan Starova në bibliotekën shtëpiake të Gijom Apolinerit, në kuartin latin të Parisit), pastaj krijimtaria popullore, çështjet e krijimtarisë letrare dhe posaçërisht zhvillimi i letërsisë shqiptare. Konica si kritik letrar i vë bazat e kritikës letrare dhe e afirmon atë në planin kulturor dhe shkencor. Ai librin e ka vlerësuar si një “monument” të rëndësishëm. I tillë është edhe opusi krijues i këtij autori të famshëm të shekullit XX.

Faik Konica është njëri ndër përkthyesit më të shquar. Shqipëroi veprat e disa shkrimtarëve të letërsisë botërore, siç janë: Kalidasa, Pjer de Ronsar, La Bryer, Viktor Hygo, Hajne, Sheli, Shiler etj. Në revistën “Albania” përktheu dhe botoi fragmente të “Iliadës” dhe të “Odisesë” të Ho-merit, fragmente të veprës së Hesiodit, pastaj shqipëroi tekste të Senekës, të Tit Livit, të Plautit, të Terencit, të Marin Barletit, të Bajronit, të Shekspirit, të Valter Skotit, të Ben Gjonsonit, të La Fontenit, të Villarit, të Bomar-shesë, të Montenjit, të Lavardinit, të Gëtes, të



Revista “Albania”

Servantesit, të Shopenhauerit, pastaj librin “Nën hijen e hurmave”, fragmente të veprës “Një mijë net e një natë”, etj.

Nga shqipja në frëngjisht përktheu veprën e Naim Frashërit “Fletore e bektashinjet”, poemën “Mili e Hajdhia” të Zef Skirroit, rapsoditë e Jeronim de Radës dhe tekste të tjera.

Më 1895 Faik Konica fillon botimin e artikujve publicistikë. Më 25 mars 1897 në Bruksel boton në gjuhën shqipe dhe frënge numrin e parë të revistës së famshme “Albania”, për

ta vazhduar botimin e saj aty deri në vitin 1902 dhe pastaj në Londër deri më 1909. Dymbëdhjetë vëllimet e “Albanisë” në dy kolona përfshijnë 4654 faqe. Kontributin e çmuar e dha Konica edhe për botimin e gazetave dhe të revistave të tjera, siç janë: revista “Albania e vogël” (Bruksel, 1899-1903), gazeta “Dielli” (Boston, 1909, 1910, 1913), gazeta “Trumbeta e Krujës” (Saint Louis, Missouri, 1911), gazeta “Ushtimi i Krujës” (Durrës, 1913-1914) nga viti 1914: drejtor Josif Bageri, “Fla-muri” (Boston, 1910), gazeta “Shqiptari i Amerikës” (Korçë, 1922-1924), gazeta “Bota e re” (Boston, 1922-1923), “Purteka” (Boston, 1923), gazeta “Kombi në rrezik” (Boston, 1923). Numri i përgjithshëm i artikujve publicistikë është shumë i madh.

Vëllimi i tretë i veprave të Faik Konicës, në 400 faqe përshin më shumë se 100 artikuj publicistikë. Mund të ketë edhe shkrime të tjera të gazetarisë, të cilat nuk janë zbuluar, kanë mbetur të shpërndara në faqet e shtypit ose në dorëshkrim.

Konica shquhet si hulumtues dhe autor i zellshëm i shkrimeve për historinë e Shqipërisë. Duke gjurmuar në arkiva, në muze, në biblioteka të ndryshme, gjen material për ngjarje dhe për figura të ndryshme historike. Artikujt me tema të historisë janë të shumtë dhe janë botuar në organe të shtypit dhe të periodikut shqiptar, por edhe në ato të vendeve të ndryshme në gjuhët e huaja. Të kujtojmë me këtë rast shkrimet për flamurin shqiptar (Konica zbuloi Flamurin Kombëtar dhe më 15 shkurt 1909 botoi punimin “Shqipëria ka një flamur autentik”), për jetën, portretin autentik dhe për armët e Skënderbeut, portretet për shqiptarë të shquar, artikullin për Patrikun shqiptar, shkrimet për arbëreshët e Italisë dhe për arbëneshët e Zarës, për ngulimet e tjera shqiptare, për humanistët shqiptarë dhe për mesjetën shqiptare në përgjithësi, për Rilindjen Kombëtare dhe për çështje të veçanta të historisë dhe të qytetërimit shqiptar. Dokumentet e panjohura për Shqipërinë, që i publikon Konica, kanë vlerë të madhe për studimin e historisë së popullit shqiptar. Vlerë të madhe për historinë, për kulturën dhe për shkencën shqiptare kanë veprat “Parashtresë mbi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare”, “Gjermania dhe Shqipëria”, “Shqipëria si më duket”, “Shqipëria: kopshti shkëmbor i Evropës Juglindore” etj.

Në veprën “Shqipëria - kopshti shkëmbor i Evropës Juglindore” të Konica përfshihet vështrimi me titullin “Gjuha dhe letërsia”. Aty jep edhe një pasqyrë të zhvillimit të letërsisë shqipe që nga fillimi i shkrimit të veprave të para letrare dhe deri te opusi letrar dhe i përkthimeve të Fan S. Nolit. Shkruan edhe për letërsinë e shekullit nëntëmbëdhjetë, “kur u bë rilindja e gjuhës

kombëtare”, dhe për romantizmin shqiptar, por nuk jep asnjë informacion shkencor për krijimtarinë e Jeronim De Radës dhe as për atë të Naim Frashërit, të këtyre dy autorëve “të letërsisë individuale apo të shkruar”, për të cilët ka shkruar shkurt në vështrimin “Letërsia shqiptare”, të botuar në numrin e parë të revistës “Albania” më 1897.

Faik Konica ka njohur shumë krijues të shquar dhe ka komunikuar me personalitete të shumta të kohës kur ka jetuar dhe vepruar. Letërkëmbimi i tij është shumë i pasur. Ai u ka dërguar letra dhe materiale të ndryshme bashkëkombësve të vet, diplomatëve, shkrimtarëve, artistëve, albanologëve të njohur, publicistëve, shkencëtarëve, burrave të shtetit, diplomatëve dhe sidomos figurave të njohura të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Në letrat e shumta ka shtruar edhe probleme të ndryshme të jetës dhe të krijimtarisë së vet letrare. Një pjesë e letërkëmbim të tij ende nuk është zbuluar. Ato janë të shkruara në gjuhën shqipe, por edhe në gjuhët e huaja. Deri më sot botimi më i plotë me epistolarin e Konicës është vëllimi 4 i veprave të plota (gati 400 faqe), zgjedhur e përgatitur nga Nasho Jorgaqi. Konica u ka dërguar letra: Fan S. Nolit, At. St Gjeçovit, Theodor Ippen-it, Visarion Dodanit, Baron Goluchowski-t, Ibrahim Temos, Z. Theohari, Asdrenit, Gaspër Jakovës, Lef Nosit, Hristo D. Qiriasit, Z. Floqi, Aubrey Herber-it, Milto Sotir Gurrës, Mehdi Frashërit, Sotir Nokës, Const. A. Demos, Nasuh Dizdarit, Loni Kristos, Kristo Kirkës, Ibrahim Shytit, Dervish Dumës, Anton Logorecit, East Horsley, Mbretit Zog etj. Në epistolarin e Konicës përfshihen edhe letrat dërguar: Aleksandër Xhuvanit, Andon Frashërit, Andon Zako Çajupit, Anselmo Lorekios, Anton Xanonit, Filip Shirokës, Gjergj Fishtës, Gjon Bazhdarit, Hil Mosit, Ismail Qemalit, Jeronim de Radës, Kolë Kamsit, Kristo P. Luarasit, Luigj Gurakuqit, Loni Logorit, Mati Logorecit, Midhat Frashërit, Mihail Gramenos, Milo Duçit, Murat Toptanit, Naim Frashërit, Ndoc Nikajt, Nelo Dizdarit, Nikolla Ivanajt, Nikolla Lakos, Nikolla Naços, Pandeli Evangjelit, Pashko Bardhit, Sami Frashërit, Sokol Bacit, Shadin Kolonjës, Tefë Curanit, Thoma Avramit, Viskë Babatasit, Zef Skiroit etj.

Konica mbajti korrespondencë edhe me dijetarët shquarj, profesorë të universiteteve dhe albanologë të njohur, siç janë: Albert Thumb, Emil Legrand, Holger Pedersen, Jan Urban Jarnik, Julius Pisko, Lui Benlëv, Max Muller, Mishel Breal, Ogyst Dozon, Viktor Anri, Zhyl Oper etj.

Autobiografia e Konicës e vitit 1922, siç shkruan Konica, përfshin "...fakte të vërtetë për jetën e Faikut. Që më 1896 e gjer më sot, 26 vjet me radhë puna e tij, çdo ditë ka qenë të mejtohet, të flasë, të shkruajë për Shqipërinë. Veprat e tij në këto 26 vjet janë sheshit dhe s`kanë nevojë për të treguar. Ato që mbetën të fshehta, janë mundimet dhe plagët të fituara në këtë luftë të dëshpëruar". Ai ka jetuar dhe ka krijuar edhe njëzet vjet të tjera me radhë. I mbeti edhe një dëshirë e fundit, e shprehur në testamentin e shkruar në Boston më 1942, për ta realizuar Fan Noli dhe Sejfulla Malëshova (Lame Kodra). Në letrën adresuar Nolit, shkruan:

"I shumënderuari Noli,

Ndërroj jetë me mejtimin se ti je njeriu që më ke kuptuar më mirë në këtë botë. Nuk do të më tretë dhe nëse ti imzot Noli dhe ti Lamja im i Vogël dhe gjithë ata që e quajnë veten shqiptarë nuk do të çojnë kufomën time të tretet në tokën mëmë. Kam lënë mënjanë edhe harxhimet e rrugës për trupin pa jetë dhe shumën për dy metra vend në Shqipëri. Mbyll sytë se do të ma kryeni këtë amanet".

Faik Konica vdiq në Washington më 14 dhjetor 1942. "Më 20 dhjetor 1942, një të diel shumë të ftohtë, u bë varrimi i tij në New England Mutul Hall, në zemër të Bostonit. Kishin ardhur për ta përcjellë në banesën e fundit qindra admirues nga vise të largëta dhe të afërta... Nuk u zhvillua ndonjë ceremoni fetare. U mbajt vetëm muzikë nga Wagneri, kompozitori i tij i preferuar. Kishte lule me shumicë, të cilat ai i deshi aq shumë sa qe gjallë". Në varrezat Forest Hills Cemetery Fan S. Noli mbajti fjalimin e rastit. Më vonë Federata Panshqiptare "Vatra" e Amerikës i ngriti përmendoren, ku, përveç shqiptonjës dykrenore, janë shkruar fjalët: "'Faik Konica /15 mars 1876 - 15 dhjetor 1942/ Gjatë gjithë jetës- mbrojtës i pavarësisë shqiptare/ Ministër i Shqipërisë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, 1926-1939".

Porosia e Faik Konicës u realizua shumë vjet më vonë. Më 1995 eshtrat e tij u sollën në Shqipëri dhe varrosët në Tiranë.

"Bibliografia e botimeve të Faik Konicës 1895-1942", e hartuar më 1991 nga bibliografi i shquar shqiptar, Jup Kastrati, përmbledh 1583 njësi bibliografike. Ajo është sistemuar në bazë të kronologjisë së botimit, sipas viteve, dhe konsiderohet bibliografia më e plotë e botimeve të këtij autori deri më sot. Në të megjithatë nuk janë të pranishme edhe shumë njësi të tjerë të bibliografisë. Të shpresojmë se në projektin e botimit të veprave të plota, të planifikuar në

kuadër të korpusit “Trashëgimi kulturor i popullit shqiptar”, do të shohë dritën e botimit bibliografik e plotë e Faik Konicës, ku do të përfshihen edhe botimet e tjera që nga viti 1942 dhe deri më sot.

Për jetën dhe krijimtarinë e Faik Konicës janë shkruar shumë artikuj, vështrime kritike, dhe studime. Vëllimi 5 i veprave të Konicës, i përgatitur nga Nasho Jorgaqi, për-mbledh afër 40 studime për Faik Konicën, të autorëve siç janë: Fan. S. Noli, Vangjel Koça, Refat Xh. Gurrazezi, Nonda Bulka, Gijom Apolineri, Luan Starova, Namik Resuli, Arshi Pipa, Ernest Koliqi, Mitrush Kuteli, Qerim M. Panariti, Martin Camaj, Rexhep Qosja, Kristo Frashëri, Jup Kastrati, Dhimitër Fullani, Alfred Uçi, Sabri Hamiti, Xhevat Lloshi, Janet Byrom, Ymer Jaka, At Artur Liolin, Nasho Jorgaqi, Ymer Çiraku, Sali Bashota, Miokom Zeço, Feti Mehdiu, Shyqri Galica, Luan Rama, Vebi Bajrami, etj.

Gjatë viteve të fundit janë shkruar edhe vepra monografike. Janë botuar edhe disa botime të veçanta të autorëve, siç janë: Faik Konica, 1876-1976, (“Vatra”, New York, N.Y. 1976), Sabri Hamiti: “Faik Konica: jam unë” (Rilindja, Prishtinë, 1991), Shyqri Galica: “Konica: Moderniteti, esejistika, kritika” (Prishtinë, 1997), Abdullah Kajragdiu: “Me Konicën në Evropë” (Tiranë, 1993), Jup Kastrati: “Faik Konica. (Monografi), (New York, 1995), “Faik Konica - Jeta dhe vepra” (Instituti Albano-logjik i Prishtinës, Prishtinë, 1997) etj.

Ymer Çiraku dhe Maksim Gjinaj kanë hartuar një “Bibliografi mbi Faik Konicën”, e cila përfshin 76 njësi bibliografike.

Duke përkujtuar Faik Konicën, i cili sipas Apolinerit “Është shqiptari më erudit i Evropës”, dhe “enciklopedi lëvizëse”, sot ndjejmë krenari të ligjshme. Fan Noli shkruan në Hyrje të librit “Shqipëria-kopshu shkëmbor i Evropës Juglindore”: “Të gjithë autorët shqiptarë që vijnë pas Konicës janë nxënës të tij, duke përfshirë edhe shkruerit e këtyre radhëve”.

Me madhështinë e tij si krijues Konica është prore i pranishëm në jetën tonë kulturore dhe shkencore. Me krijimtarinë e tij letrare ai kthehet ngadhënjimtar në Historinë e letërsisë shqiptare.

Në disa portretet letrare kushtuar shkrimtarëve dhe figurave të shquara kombëtare, Faik Konica shpalon kujtimet dhe shpreh dashurinë, nderimin dhe krenarinë: “Edhe ne i falemi me mall e me nder këtë atdhetari të pavdekur” - Naim Frashërit, “Këtij shqiptari të vërtetë, le t'i

falemi, O Shqiptarë! - Jeronim de Radës, “Humbja për Shqipërinë është e madhe” - Bajram Currit, “Emri i këtij njeriu do të vijë duke u rritur...” - Shtjefen Gjeçovit.

Duke përfunduar këtë shkrim për Faik Konicën, të rikujtojmë fjalën e Nolit më 20 dhjetor 1942: “...Faik Konitza meriton këtë nderim që po i bëhet. Pa fjalë më tepër se cilitdo tjetër, Faik Konitza meriton të gjenjë prehjen në tokën e atdheut, të cilit i ka shërbyer tërë jetën me aqë besnikëri, me aqë trimëri, dhe me aqë zotësi”.

Prandaj me nderim dhe krenari përkujtojmë jetën dhe veprën e Faik Konicës, të shkrimtarit eminent të letërsisë moderne shqiptare, të personalitetit të shquar të kulturës shqiptare dhe evropiane.

NE KOPIRATET

LITERATURA

- Apoliner, Gijom. *Faik Konica, Fletore për Konicën*, Tiranë, 1962
- Bajrami, Vehbi. *Kujtime për Faik Konicën*. Në: F. Konica, *Vepra 5*, Tiranë, 2001, f. 419-426.
- Bart, Rolan: *Aventura semiologjike, Rilindja*, Prishtinë, 1987
- Bashota, Sali. *Faik Konica nismëtar i prozës moderne shqipe*. “Jeta e re”, Prishtinë, nr. 3, 1995, f. 421-426.
- Berisha, Anton. *Qasje komplekse botës shqiptare; Shqipëria- Kopshti shkëmbor i Evropës Juglindore*, “Jeta e re”, Prishtinë, nr. 3, 1995, f. 443-446
- Bouazis, Ch.: *Analyse de la périodisation littéraire*, Textes réunis par Ch. Bouazis, Ed. universitaires, Paris, 1972
- Bulka, Nonda. *Faik Konica kundër Naimit*. Në F. Konica, *Vepra 5*, Tiranë, 2001, f. 31-38.
- Bulo, Jorgo: *Magjia dhe magjistarët e fjalës*, “Dituria”, Tiranë, 1998
- Byrom, Janet. *Faik Konica dhe gjuha letrare shqipe*. Në: F. Konica, *Vepra 5*, Tiranë, 2001, f. 297-300.
- Camaj, Martin, *Mbi funksionin e gjuhës së Nolit dhe të Konicës. Fletore për Konicën*, Tiranë, 1992
- Ceserani, Remo, *Guida allo studio della letteratura*, Editori Laterza, Botimi i dytë, Roma-Bari, 2003
- Chevrel, Yves: *Letërsia e krahasuar*, Tiranë, 2002
- Cuddon, J.A: *Dictionary of Literary Terms and Literary Theory*, Penguin Books, London, 1991
- Çabej, Eqrem: *Shqiptarët midis perëndimit dhe lindjes*, Tiranë, 1994
- Çausi, Tefik: *Fjalor i estetikës, Onufri*, Tiranë, 1998
- Çiraku, Ymer. *Faik Konica- “i shuguruar” si themelues i kritikës letrare në Shqipëri*. SAI, nr. 1, 1996, f. 50-54; Në Y. Çiraku, *Në zërbërthim të kodeve letrare*, Tiranë, 1998, f. 16-22.
- Çiraku, Ymer- Gjinaj Maksim. *Bibliografi mbi Konicën*. Në: F. Konica, *Vepra 5*, f. 437-446.
- Dado, Floresha: *“Teoria e veprës letrare Poetika”*, SHLB, Botimi i dytë, Tiranë, 2003
- Destani, Bejtullah D. *Faik Konitza*, 2001
- « Dictionnaire mondiale des littératures », Larousse, Paris, 2002
- Çështje të romanit, *Rilindja*, Prishtinë, 1980
- Dictionnaire étimologique*, Larousse, Paris, 1971
- Dictionnaire littéraire*, Paris, 2003
- Elsie, Robert, *Historia e letërsisë shqiptare*, “Dukagjini”, Tiranë-Prishtinë, 1997
- Faik Konica- Jeta dhe vepra*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1997
- Frashëri, Kristo. *Kush ishte Faik Konica. Nëntori*, nr. 1, 1991, f. 75-96; “Jeta e re”, Prishtinë, nr. 3, f. 332-352.
- Frashëri, Kristo. *Vendi i Faik Konicës në kulturën shqiptare. Fletore për Konicën*. Tiranë, 1992, f. 8-9
- Fullani, Dhimitër. *Proza e Faik Konicës*. Në: F. Konica, *Vepra 5*, Tiranë, 2001, f. 235-248.
- Galica, Shyqri. *Konica: Moderniteti, estetika, kritika*. Prishtinë, 1997
- Genigs, Mabelle. *Nga jetëshkrimi i zotit Faik Konica*. Në: F. Konica, *Vepra 5*, Tiranë, 2001, f. 427-431.
- Gradilone, Guiseppe, *Studi di letteratura albanese*, Roma, 1960
- Gurakuqi, Mark: *“Autorë dhe probleme të letërsisë përparimtare shqipe së viteve `30”*, Tiranë, 1966
- Gjergji, Andromaqi. *Faik Konica dhe kultura popullore shqiptare*. SAI, nr.2, 1996, f. 65-74.

- Gjika, Kastriot. *Faik Konica*. Në: *Studime letrare*: Për mësuesit e shkollave të mesme. Tiranë, 1998, f. 49-57.
- Gjika, Thanas. *Një roman i ri i pambaruar i Faik Konicës: Doktor Gjilpëra...* Rilindja, 11 dhjetor 1993, f. 6.
- Hamiti, Sabri: *Faik Konica- Jam unë*, “Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve” & Shtëpia Botuese “Onufri”, Tiranë, 1994
- Hamiti, Sabri, *Studime letrare*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2003
- Historia e letërsisë botërore, 1-7, Rilindja*, Prishtinë, 1984-1987
- Historia e letërsisë shqipe I*, Universiteti Shtetëror i Tiranës-Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë, 1959
- Historia e letërsisë shqipe II*, Universiteti Shtetëror i Tiranës- Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë, 1960
- Historia e letërsisë shqiptare*, Akademi e Shkencave e RPS të Shqipërisë Instituti I Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1983
- Historia e letërsisë shqiptare e realizmit socialist*, AKSH e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1978
- Ismajli, Rexhep. *Polemikë shembullore e Konicës*. Në: R. Ismajli, *Etni dhe modernistet*. Pejë, 1994
- Jaka, Ymer. *Veprimtaria e Faik Konicës për integrimin e shqiptarëve në rrjedhat e qytetërimit evropian*. Në: F. Konica, *Vepra 5*, Tiranë, 2001, f.301-311.
- Jorgaqi, Nasho: “Poetika e dokumentit”, Tiranë 2000
- Jorgaqi, Nasho. *Parathënie*. Në: Faik Konica, *Vepra*, Tiranë, 1993, fr. 13-51.
- Jorgaqi, Nasho. *Enigmat dhe befasitë e trashëgimisë koniciane*. Në: F. Konica, *Vepra 5*, Tiranë, 2001, f. 315-319.
- Kadare, Ismail: “*Ftesë në studio*”, Tiranë, 1990
- Kadare, Ismail: *Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe*, Tiranë, 1981
- Kajragdiu, Abdullah. *Me konicën në Evropë*. Tiranë, 1993
- Kastrati Jup, *Faik Konica*, “Gjonlekaj Publishing Co”, New York, 1995
- Koça, Vangjel. *Tingëllima të jetës shqiptare (Faik Konica)*. Shkëndija, V. III, nr. 2. Dhjetor, 1942, f. 46-47.
- Koliqi, Ernest: *Saggi di letteratura albanese*, Firenze, 1972
- Koliqi, Ernest. *Faik Konica*. “Shejzat”, Romë., Nr. 5-8, maj-gusht, 1967, f. 240-246.
- Koliqi, Ernest. *Zejtari i shkrimit, qi i shndërron fjalët në djamanta*. Në: F. Konica, *Vepra 5*, Tiranë, 2001, f. 80-88.
- Konica, Faik. *Autobiografia e faik Konicës*. Në: Faik Konica, *Vepra*, Tiranë, 1993, f. 5-10.
- Konica, Faik, - *Jeta dhe vepra*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1997
- Konica, Faik: *Vepra*, “Naim Frashëri”, Tiranë, 1993
- Konica, Faik. *Kopshti Shkëmbor i Evropës Juglindore*, “Buzuku”, Prishtinë, 1991
- Konica, Faik: *Vepra 1-5, Botimet Dudaj*, Tiranë, 2001
- Konica, Faik: *Ç’është Liria Ese të zgjedhura*, Tiranë, 2005 (Përgatitur nga Nasho Jorgaqi)
- Koreshi, Vath. *Duke kujtuar Fikun. Rilindja demokratike*, 22 dhjetor, 1996, f. 7.
- Kurti, Ledri. *Konica, prozë dhe kritikë*. 2008
- Kuteli, Mitrush. *Fytyra e madhe e Faikut*. Në: F. Konica, *Vepra 5*, Tiranë, 2001, f.89-90.
- Kratkaja literaturnaja enciklopedija 1-9*, Moskva, 1962- 1978 *La modernité*, [http://fr.encyclopedia.yahoo.com/ articles/ni/ni_1438_p0.html](http://fr.encyclopedia.yahoo.com/articles/ni/ni_1438_p0.html), f.1-2
- Kuçuku, Bashkim, *Kadare në gjuhët e botës*, Botimi i dytë, “Onufri”, Tiranë, 2005
- Lafe, Emil. *Për neologjizmat e Faik konicës*. SF. Nr. 1-4, 1995, f. 55-59.
- Le dictionnaire du Littéraire*, PUF, Paris, 2002

- Legouis-Cazamian's : *History of English Literature*, London, 1971
- Leksikon književnih termina*, Institut za književnost i umetnost u Beogradu, Nolit, Beograd, 1985
- Liolin, At Artur. *Kampion i shqiptarizmit*. Në: F. Konica, Vepra 5 , Tiranë, 2001, f. 312-314.
- Littérature, XX e siècle*, Nathan, 2003
- Littérature XX e siècle, Collection Hanri Mitterand*, Paris, 2003
- Littérature XX e siècle, Collection Hanri Mitterand*, Paris, 2003
- Letërsia si e tillë*, Akademia e Shkencave- Instituti i Gjihësisë dhe i Letërsisë, "Toena", Tiranë, 1996
- Lloshi, Xhevat. *Stili i Faik Konicës. Gjuha jonë*, Tiranë, nr. 1.-4, 1993, f. 66-73.
- Markjeviç, Henrik ; *Nauka o književnosti*, Nolit, Beograd, 1974
- Marquez, Gabriel Garcia & Llosa, Maria Vargas, *Dialog për romanin latino amerikan*, Onufri, Tiranë, 2001
- Mehdiu, Feti, *Faik Konica- përkthyes i parë i përrallave të Arabisë në gjuhën shqipe*. Në : F. Konica, Vepra 5 , Tiranë, 2001, f. 395-400.
- Noli Fan S. *Fjala funerale për faik Konicën*. Jeta e re, Prishtinë, nr. 5. 1995, f. 303-307.
- Noli Fan S. Parathënie. Në : F. Konica, *Shqipëria- Kopshti shkëmbor i Evropës Juglindore*, Prishtinë, 1991, f. 11-17.
- Osmani Tomor. *Faik Konica (1875-1942) dhe revista « Albania » (1897-1909)*. Në : T. Osamni. *Udhë e shkronjave shqipe. Histori e alfabetit*. Shkodër, 1999, f. 409-423.
- Panariti, Qerim. *Faik Konica një kalorës i atdhetarisë shqiptare*. Në : F. Konica , *Shqipëria : Kopshti shkëmbor i Evropës Juglindore*, Prishtinë, 1991, f. 19-30 ; *Jeta e re*, Prishtinë,
- Pipa, Arshi. *Faik Konica. Jeta e re*, Prishtinë, nr. 3, 1995, f.297-302.
- Pipa, Arshi. *Çelësi i personalitetit të Faik Konicës*. Në : F. Konica, Vepra 5 , Tiranë, 2001 , f.62-71.
- Pipa, Arshi. *Naim dhe Sami Frashëri për Konicën*. Në : F. Konica, Vepra 5 , Tiranë, 2001, f.72-79.
- Rečnik književnih termina*, "Nolit", Beograd, 1985
- Qosja, Rexhep. *Faik Konica*. Në: J. Kastrati, *Faik Konica (Monografi)*. New York, 1995, f. 5-28.
- Qosja, Rexhep. *Ngadhjmtar i vonuar. Fletore për Konicën*. Tiranë, /1992/. f. 7, 9.
- Qosja, Rexhep. *Nocione të reja albanologjike*, IAP, Prishtinë, 1983
- Rama, Luan. *Konica dhe Apolineri në rrjedhat e integritit dhe qytetërimit evropian*. Në: F. Konica, Vepra 5 , Tiranë, 2001, f.412-418.
- Ressuli, Namik. *Faik Konitza (Konica) (1875)*. Në: Shkrimtarët shqiptarë, pj. II. Tiranë, 1941, f. 236-241.
- Ressuli, Namik. *Faik Konitza në qindvjetorin e lindjes*. Në: *Faik Konitza 1876-1976*. New York, 1976, f. 3-20; *Jeta e re*, Prishtinë, nr. 3., 1995, f. 359-375.
- Ressuli, Namik. *Volteri shqiptar*. Në: F. Konica, Vepra 5 , Tiranë, 2001, f. 56-61.
- Rexhaj, Besim. *Faik Konica në dritë të re. Fjala*, Prishtinë, nr. 21, qershor, f. 12.
- Rugova, I.-Hamiti, S. *Kritika letrare*, "Rilindja", Prishtinë, 1979
- Rugova, Ibrahim. *Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare*, Botimi i dytë. Prishtinë, 1996

Rugova, Ibrahim. *F. Konica Vetëdija për nevojën e kritikës*. Në: *Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare: 1504-1983*. Tiranë, 1996, f. 62-83.

Rrjedhat e letërsisë bashkëkohore shqiptare, ASHK, Prishtinë, 2005

Sartre, Jean Paul: *Quest-ce que la literature?*, Paris, 1964.

Sevdail Kastrati. *Lufta e penave, Botimet Toena* Tiranë, 2002

Sinani, Shaban. *Konica- ky sy kritik i historisë*. Në: Sh. Sinani, *Sipërrore*. Tiranë, 1998, f. 36-40.

Sinani Shaban. *Nga ndëgjegja romantike tek vetëdija kritike. Fletore për Konicën*. Tiranë, /1992/, f. 10, 12.

Starova, Luan. *Faik Konitza et Guillaume Apollinaire : Une amitie europeene*. *Edition établie et présentée par Luan Starova*. Paris : L'Esprit des Péninsules, 1998.

Starova, Luan. *Faik Konica dhe revista e Gijom Apolinerit "Gostia e Ezopit" (1903-1904)*. Në: F. Konica, *Vepra 5* , Tiranë, 2001, f. 45-55.

Starova, Luan: *Faik Konitza et Guillaume Apollinaire: Une amitie europeene*, 1998

Starova, Luan. *Ese për gjuhën natyrore dhe artificiale*. Në: F. Konica, *Vepra 5* , Tiranë, 2001, f. 348-385.

Starova, Luan. *Faik Beg Konitza : une simphonie inacheve*. Në : Amis europeens d` Apollinaire. Press de la Sorbonne Nouvelle. Paris, 1995

Studime dhe kritika letrare, "Naim Frashëri, Tiranë, 1983

Studime për letërsinë shqiptare II, ASHSH, Tiranë, 1988

Shaplo, Dalan. *Faik Konica, magjistar i fjalës shqipe: Faik Konica- Vepra*. Në: D. Shaplo.

Duke kërkuar të vërtetën dhe humanizmin. Tiranë, 1999, f. 77-82.

Shema, Isak: [Bibliografi e kritikës letrare shqiptare 1944-1974, \(Bashkautor Ibrahim Ru-gova\), Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1976. Ribotoi Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Kosovës, Prishtinë, 1997;](#)

Shema, Isak: *Bibliografite e letërsisë dhe të kritikës letrare shqiptare*, në "Procedime letrare", Prishtinë 1999

Shema, Isak: *"Të dhëna të reja lidhur me botimin e revistës "Albania" në Bruksel (1897-1902), "Gjurmime albanologjike – Seria filologjike"*, Prishtinë, 1975, nr. V, f. 119- 125.

Shema, Isak: *Aspekte të letërsisë*, "Rilindja", Prishtinë, 1985

Shema, Isak: *"Vrojtme letrare dhe artistike"*, "Rilindja", Prishtinë, 1995

Shema, Isak: *Studime letrare*, "Rilindja", Prishtinë, 1999

Shema, Isak: *"Romani bashkëkohor shqiptar dhe kritika letrare"*, "Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 1988, nr. 13, f. 137-141.

Shema, Isak : *Vlerësime të faik Konicës për Veprimtarinë e Jeronim De Radës*. Seminari V Ndërkombëtar për studimet Arbëreshe/V Seminario Internazionale di Stusi Itali-Albanesi./*Figura dhe vepra e J. de Radës/100 Vjetori i vdekjes 1903-2003*.Itali, Cosenza, 2-5 tetor 2003

Shema, Isak: *"Faik Konica-shqiptari më erudit i Evropës"*, "Ekskluzive", Prishtinë, 2003, nr. 34, f. 112-114.

Shema, Isak. *Veprimtaria e Faik Konicës në Bruksel (1896-1902)*. Në: F. Konica, *Vepra 5* , Tiranë, 2001, f. 327-337.

- Shkrimtarë shqiptarë II*, Tiranë, 1943
- Shuteriqi, S. Dhimitër: *Nëpër shekujt letrarë*, “Naim Frashëri”, Tiranë, 1973
- Shuteriqi, Dhimitër S. *Faik Konica- një i panjohur*. *Kombi*, 17 qershor, 1994., f. 5,11; 12 qershor, 1994, f. 5.
- Tadie, Jean-Yves: *La critique litteraire au xx siecle*, Paris, 1977.
- Uelek, Rene- Uoren, Ostin: “*Teoria e letërsisë*”, SHBE, Tiranë, 1993
- Uçi, Alfred. *Faik Konica- ekscentriku*. Në: F. Konica, *Vepra 5* , Tiranë, 2001, f. 249-264.
- Uçi, Alfred: *Probleme të estetikës*, “Naim Frashëri”, Tiranë, 1976
- Velek, Rene - Voren, Ostin: “ *Teoria e letërsisë* “, “Rilindja”, Prishtinë, 1982
- Vinca, Agim: *Alternativa letrare*, Shkup, 1995.
- Xhiku, Ali: *Nga romantizmi rrjedhave të realizmit*, Tiranë, 1989.
- Xhiku, Ali: *Letërsia shqipe si polifoni*, Tiranë, 2004.
- Zeço, Moikom. *Faik Konica- emblemë e kombit*. Në: F. Konica, *Vepra 5* , Tiranë, 2001, f.386-394.
- Zeço, Moikom. *Paradokset e demokracisë*. Tiranë, 1994, f. 91-105.
- Zhiti, Visar. *Antifunerali i Faik Konicës: Vepra*. *Republika*, 28 nëntor, 1993, f. 1-2.
- Zhyllia, Didie: “*Fjalor i filozofisë*”, “Larousse” , SHBE, Tiranë, 1994

PR

DIOGEN pro kultura

<http://diogen.weebly.com>